



Komuna Klinë

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-25281 2023

Klinë, dt: 01.08 /2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës mbajtur me datë 30. 06. 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje; Kryetari i Komunës z. Zenun Elezaj, nënkyetarja znj. Marqe Selmanaj, drejtori e drejtorive, Komandanti i policisë në Klinë, media lokale, anëtarët e kuvendit, qytetarë.

Mbledhja është transmetuar audiovizive drejt për drejt nga Klinainfo dhe Radio Alba.

Mbledhja ka zgjatur 2 orë e 22 minuta dhe sipas udhëzimeve të kryesuesit procesverbalë është shkruar në formë ekstrakti duke pasqyruar qëndrimet, propozimet dhe mendimet e përbledhura të të gjithë pjesëmarrësve që kanë marrë fjalën.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi hapi mbledhjen e kuvendit duke përshëndet kryetarin e komunës, anëtarët e kuvendit, dhe gjithë të tjërët të pranishëm në sallë. Kryesuesi konstatoi se të pranishëm janë 25 anëtarë të Kuvendit dhe mbledhja mund të vazhdoj punimet. Që në fillim të fjalës së tij kryetari kërkoj një minutë nderim për ish punëtorin e administratës së Komunës, Nazmi Elshani, i cili u nda ngajeta para disa ditëve. Pas një minutë nderim nga të gjithë të pranishmit, kryesuesi shpjegoi se për dy anëtarë të kuvendit që mungojnë, z. Esat Raci dhe z. Asdren Ramadani ka marr informacion zyrtar se janë jashtë vendi.

Rreth Rendit të ditës para se të vihet në votim, fjalën e kërkuan, z. Zafer Gashi dhe z. Valmir Bacaj.

z. Zafer Gashi ishte i interesuar të dijë për dokumentacionin që kryesuesi e ka përmendur para dy seancave. Ka të bëjë me fjalën e kryesuesit se ka dokumentacione- leje të lëshuara nga ministritë për shfrytëzimin e disa hapësirave për gurëthyes e të tjera. Z. Zafer Gashi do të dëshironë që të i kemi ato dokumente të shihet se kush i ka lëshuar, të jetë pikë e rendit të ditës sot kjo dhe të shihet se sa është impakti i komunës në krejt këtë. Sipas z. Gashi në

qeveri nuk ka dokumente të tilla të lëshuara në kohën e ministrit aktual të mjeshtit dhe ambientit.

z. Fadil Gashi , tha se pikërisht këta ministra aktual i kanë dhënë këto leje dhe nëse është i interesuar z. Zafer Gashi pas seance të vijë në zyrën e kryesuesit dhe të i merr të gjitha ato leje të lëshuara për të cilat ka folur kryesuesi.

z. Valmir Bacaj kërkoj sqarim nga LVV që të sqarojnë se në çka janë bazuar kur kanë kërkuar interpelancë. Në kërkesë sipas z. Bacaj, LVV është thirr në ligjin për vetëqeverisje lokale dhe kérkon që të shpjegoj LVV se në cilin nen të këtij ligji janë thirrur sepse sipas z. Bacaj çështjen e thirrjes së interpelancave e rregullon rregullorja e punës së Kuvendit. Interpelancë ka të drejt të thirr grupi kuvendar por LVV në Kuvend nuk është grup kuvendar.

z. Fadil Gashi, kryesues tha se kjo bëhet për hirë të efikasitetit të kuvendit dhe praktikës edhe në të kaluarën. Është e vërtete se grup me dy anëtarë nuk ka. Por sipas praktikave edhe një anëtarë mund të thirr interpelancë. Nuk shkelim asgjë edhe nëse e vendosim interpelancën e thirrur në këtë rast por edhe nëse e heqin nga rendi i ditës prap nuk bëjmë shkelje. Po ashtu z. Gashi tha se këtë edhe mund ta bëjmë bashkë në një pikë të rendit të ditës. Ne e kemi vendosë në rend të ditës, ky është propozim për rend dite por ju vendosni me votën tuaj ta aprovoni apo ndryshoni këtë rend të ditës.

Edhe z. Kushtrim Haliti kishte disa shqetësime që dëshironë të i paraqes para se të aprovohet Rendi i ditës. Z. Haliti kishte vërejtje për mënyrën e ftesave që drejtoria e Kulturës dhe këshilli organizativ i Festivalit Folklorik i mbajtur me datë 6.7 dhe 8 qershor të këtij viti. Z. Haliti tha se nuk janë ftuar as anëtarët e kuvendit edhe as OVL e UCK. Po ashtu as për ditën e çlirimt nuk janë bërë ftesa. Ne fakt janë bërë ftesa një ditë pas ditës së çlirimt dhe as nuk është mbajtur seancë solemne për ditë të çlirimt, kjo sipas z. Haliti ka ndodhë për herë të parë pas luftës.

Kryesuesi , z. Fadil Gashi tha se seanca thirrët për anëtarët e kuvendit por merrni të gjitha incizimet kur kemi mbajtur seanca solemne dhe e shihni që as gjashtë anëtarë të kuvendit nuk kanë marr pjesë, prandaj nuk e kemi mbajt duke u nisë nga ky fakt. Sa i përket ftesave të tjera si ato të festivalit, mendoj që në shtëpi tonë nuk kemi pse të bëjmë ftesa por sipas protokollit keni të drejtë. E diji se shërbimi i kuvendit më ka sqaruar, zyrtari Ahmet Berisha ka genë në pushim.

Z. Kushtrim Haliti në lidhje me këtë tha së ne mund të pajtohem sepse kemi familjarët që kanë dhënë shumë për këtë vend dhe mund të vijmë edhe pa na thirrë fare. Sidoqoftë protokolli duhet të respektohet. Zyra për punë e Kuvendit nuk e ka vetëm Ahmetin, ka edhe punëtorë të tjerë aty. Problemi është se përfaqësuesit e OVL nuk i kanë ftuar fare as në këshillin organizativ të festivalit.

**Me propozimin e kryesuesit mbeti që kjo të merr përgjigje në pikën e fundit të rendit të ditës: Pyetje dhe Përgjigje.**

z. Valmir Bacaj tha se në lidhje me pikën 14 dhe 15 të rendit të ditës të hiqen nga rendi i ditës dhe të respektohet ligji. Kurdo që LVV ta sheh të arsyeshme për interpelancë të kërkoj nga grupi ynë ne do të jua japim nënshkrimin. Të dy pikat të shkrihen në pikën e fundit- Pyetje dhe përgjigje.

z. Zafer Gashi kërkoj që të përgjigjet kryetari Elezaj nëse është i gatshëm të përgjigjet. Qëllimi i interpelancës sipas z. Gashi është që të diskutohen disa çështje që mund të bëhen më mirë.

Reagoi sërisht z. Bacaj duke kërkuar dhe u dakorduar që të respektohet vetëm rregullorja dhe ligjet mbi vetëqeverisjen lokale. Duhet të krijohet një praktikë që të respektohet ligji e rregullorja. Kryetari është i gatshëm të përgjigjet gjithsesi.

Në lidhje me rendin e ditës foli edhe z. Arben Limanaj i cili tha se në lidhje me shqetësimet e ngritura nga grupi i LVV, nuk mendoj që duhet të hiqet nga rendi i ditës përveç nëse deklarohet kryetari që nuk është i gatshëm.

Kryesuesi sqaroi se nuk kërkoj askush të hiqet nga rendi i ditës por të zhvendoset në pikën e fundit – Pyetje, përgjigje.

**Me propozimin që dy interpelancat, pika 14 dhe 15 të zhvendoset tek Pyetje dhe përgjigje , rendi i ditës u vendos në votim. Me 19 vota për, dy abstenime , asnjë kundër u miratua. 23, 45.**

#### **Pika 1 e Rendit të ditës: Arsyetimi i mungesave**

Kryesuesi tha se mungojnë Esat Raci dhe Asdren Ramadani të cilët janë jashtë vendi

#### **Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

#### **Me 23 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

Procesverbal i seancës së jashtëzakonshme mbajtur me 13 shkurt 2023 gjithashtu u MIRATUA me 23 vota pér asnje kundér dhe asnje abstenim.

#### **Pika 3 e Rendit të Ditës: shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së**

Kryesuesi sqaroi se janë vetëm dy rekomandime që nuk janë në rend të ditës. Një nga OJQ "Zana" që kérkon një hapësirë pér ushtrim të aktiviteteve të saja por se me ligj duhet të i nënshistrohet ankandit kur të hapet sikurse të gjitha organizatat e tjera.

#### **Me 23 vota pér asnje kundér dhe asnje abstenim U MIRATUAN**

**Pika 4 e Rendit ét Ditës: Shqyrtimi i raportit nga procesi i dëgjimeve buxhetore pér kornizën afatmesme buxhetore 2023-24.**

Kryesuesi tha se është praktikë e re dhe po ashtu edhe material i ri. Një raport që ju mundëson të shihen të gjitha aktivitetet e organizuara në lidhje me KAB. Nuk ka nevojë pér miratim por vetëm pér shqyrtim.

**z. Arben Limanaj:** Unë dua që të shpreh një shqetësim tek ky raport. I Kam parë dëgjimet publike por nuk kam parë ndonjë anëtarë të kuvendit që vije nga ato lokalitete pérveç ekzekutivit. Nuk e diji pse nuk e ka paraparë Ekzekutivi që të i ftoj edhe anëtarët e kuvendit nga ato lokalitete. Nuk e diji pse ju akne shhang apo akne dashur që të marrin pjesë vetëm partiakët e vet. Herë tjetër kur ekzekutivi dëshiron votën tonë duhet paraprakisht të konsultohen. Vota bllanko nuk ka.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Unë shumë i kam lutë anëtarët e KPF që të dalin e të marrin pjesë në këto dëgjime. Po ashtu, kemi organizuar një takim përmes OSBE dhe prej 27 anëtarëve të Kuvendit vetëm 5 veta kanë marrë pjesë. Nuk po vini në takime.

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Përshëndetje të gjithëve. Përveç që dua të jap një përgjigje në atë që e ngriti z. Limanaj, dua ti them edhe dy tri fjalë pér materialin që ju ka ardhur. Personalisht këtu në asamble kam bërë ftesë publike që të përcillet axhenda e ekzekutivit pér KAB. Secili që ka dashur të marr pjesë ka pasur mundësi të jetë prezent. Ftesat janë bërë me kohë edhe në asamble por edhe ne ueb të komunës. Kemi dalur në teren ashtu siç e parasheh ligji që përmes dëgjimeve bashkërisht me qytetarët të hartoher plani i investimeve në kuadër të KAB. Dua të i falënderoj të gjithë ata qytetarë që akne marrë pjesë pér kontributin dhe angazhimin e tyre serioz. Mundësia e juaj vazhdon që të jetë që të jepni vërejtje e propozime edhe më tutje.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Vendimin pér lëshuarje në diskutim publik e kemi nxjerrë në këtë kuvend. Unë si kryesues i kuvendit e kam nënshkruar vendimin pér lëshuarje në debat publik. Ky është organizim i yni si kuvend.

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje. Unë shfrytëzoj rastin të ju uroj festen e Bajramit të gjithë shqiptarëve. Rreth dëgjimeve [publike dua të ju falënderoj pér angazhimin tuaj. Unë kam marr pjesë , kam pasur ftesë.

**z. Kushtrim Haliti:** Përshëndetje. Unë absolutisht nuk pajtohem me z. Enver Berisha i cili thotë se ka pasur asamblistë. Ne nuk kemi qenë të informuar fare. Prej 7 fshatrave që përbehet bashkësia Lokale e Jashanicës vetëm dy anëtarë kemi marrë pjesë. Prandaj mos e quani të suksesshëm.

**Znj. Ilirjana Toplanaj:** Përshëndetje të gjithëve. Njoftimi ka qenë publik, as mua nuk më ka ftuar askush por unë kam marrë pjesë. Nuk e diji pse duhet me na ftuar kur e kemi përgjegjësi.

Në lidhje me ftesën apo mos ftesën për pjesëmarje në dëgjime publike për KAB debati vazhdoj akoma më tej ku fjalën e morri për të disten herë z. Arben Limanaj, Kryesuesi Fadil Gashi, Kushtrim Haliti etj.

#### **Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kornizës afatmesme buxhetore.**

- z. Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Duke u bazuar në ligjin për financa publike ne kemi marr orientimet nga niveli qendror për kornizën afatmesme buxhetore. Karshi kësaj i kemi bërë edhe debatet në teren. Fillimisht po prezantoj shifrat e buxhetit për vitin 2024. Buxheti për vitin 2024 është 14 milion e 798 mijë euro e 718. Është 700 mijë euro më i madh se sa buxheti aktual i këtij viti. Në kuadër të këtij buxheti janë të hyrat vetanak të planikuara që sigurohen nga qiraja, bizneset, taksat, dënimet dhe që ju kthehet qytetarëve me investime. Grandi që ne marrim nga niveli qendror është 13 milion e 361 mijë euro e 450. Në kuadër të këtij buxheti total janë të ndara edhe kategoritë shpenzuese. Shuma më e madhe shkon në paga dhe mëditje.
- z. Berisha** në vazhdim specifikoi kategoritë dhe planifikimet e bëra të mjeteve buxhetore nëpër këto kategori për vitin 2024. Në 2025, 2026 buxheti rritet vazhdimesht nëpër kategori bazuar në rritjen e buxhetit. "Jam i gatshëm që të përgjigjem në interesimin tuaj", tha z. Berisha në fund të fjalës së tij.
- z. Tunë Dedaj:** jam i kënaqur që është planifikuar që deri në vitin 2026 do të rritet buxheti në Bujqësi pasi që është shumë e rëndësishme kjo rritje në këtë sektor. Ujita e tokave jep prodhim.
- z. Ndrec Zefaj:** Përshëndetje të gjithëve. Sot po e diskutojmë KAB 2024-2026 që është dokumenti më i rëndësishëm. Dua të ndalem tek pika e zhvillimit ekonomik. Ndërmarrësia që përfshin zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për vitin 2024 nuk parashihet fare të ketë buxhet. Bujqësia, shihet gjithashtu se nuk ka rritje të buxhetit. Kërkoj që në këto pika të rritet buxheti sepse duke mbështetur zhvillimin ekonomik dhe politikat e punësimit direkt komuna do të arrij që të zgjedhoj emigrimin e qytetarëve.
- z. Zafer Gashi:** Arsy që nuk u kyçem në pikën paraprake është se mënyra se si është organizuar dhe prezantuar lenë për të dëshiruar shumë. Tek KAB 2024-2026 mendojmë që nuk është në nivelin se si do të duhej të ishte. Kam parë disa ekspert të jashtëm, jam çuditë kur e kam parë një profesor të gjeografisë. Sa i përket planifikimeve për këto periudha lënë shumë për të dëshiruar. Planifikimi buxhetor tek kodi 7, 50405 shfrytëzimi i pronës publike, qiraja për tregjet e hapura. Qe nga 2024 deri në 2026 shkon duke u rritur pagesa për qiratë. Kjo tregon se ju nuk keni planifikuar që të i shfrytëzioni të ardhurat që komuna i merr nga pronat publike. Mendoj që as 10% nuk është përfshi shfrytëzimi i pronave- planifikimi i shfrytëzimit të këtyre pronave. E përmendet se mjetet më të mëdha do të shkojnë për paga dhe mëditje por kryetari duhet të sqaroj se çfarë planifikimi ka bërë për punësimin e njerëzve.

z. Zafer Gashi në fjalën e tij kishte vërejtje të tjera por në fund tha se këtë dokument nuk do ta votojnë.

**z. Kushtrim Haliti:** Gjatë shfletimit të këtij draft kornize kemi vërejtur disa mangësi. P.sh. Ndërtimi i rrethojave të qytetit. Qysh e diji unë ato janë të rrethuara. Shtegu për ecje në Pograxhë për tre vite 275mijë euro, rruga Klinë-Shtupel-Bingjë 330 mijë euro. Nuk e diji çka ka me u investu në atë rrugë. Unë kaloj nëpër atë rrugë dhe ajo është shumë e mirë. Investimet do të duhej planifikuar në fshatin Gjurgjevik të madh ku familje nga një pjesë e lagjes kanë marr me qira shtëpi në një pjesë tjetër të lagjes vetëm që fëmijët ta kenë më të lehtë të shkojnë në shkollë. Po ashtu në lagjen mbi stacion asnje investim nuk është bërë e as planifikuar. Një lagje që ka mbetur shumë mbrapa në tërë komunën e Klinës. Ne si grup kuvendar do ta votojmë këtë draft pasi që edhe kështu siç është përfitojnë disa qytetarë dhe fshatra të Klinës por duhet bërë disa ndryshime gjithsesi.

**z. Valmir Bacaj:** KAB paraqet një përbledhje të planifikuar për periudhën afatmesme 2024-2026. Bazuar në këtë dokument që i akne parapri debate dhe dëgjime publike, materiali siguron një analizë të hollësishëm të shpenzimeve dhe paraqet një planifikim të mirë për zhvillim të komunës. Ne si grup kuvendar do ta përkrahim KAB dhe do ta votojmë.

**z. Arben Limanaj:** Unë shqetësimet që i pata rreth hartimit të kornizës i paraqita. Si shef i grupit të LDK kërkoj që dokumente të tilla si kjo për ta mbështetur nga grupei ynë duhet që të na konsultojnë përndryshe në të ardhmen nuk do ta mbështesim. Nuk mund të bëhen konsultime vetëm me anëtarë dhe militant të partisë por edhe me ne asamblistët dhe grupet kuvendare. Shqetësim tjetër që dëshiroj të shpreh, tek DKA më bëri përshtypje tek vizioni, ishin evidentuar 15 mijë e më shumë nxënës, nuk besoj që është reale kjo shifër. Nëse është vizion që të bëhen gjithë këta nxënës do të ishte mirë por e parealizueshme. Ndoshta është marrë "copy past" nga ndonjë komune tjetër si e dhënë.

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZh:** Një sqarim për zotin Zafer Gashi. Tarifat, taksat nuk i bënë drejtoria dhe ekzekutivi por është vendim i kuvendorit. Te shuma e pagave dhe mëditjeve përvèç planifikimi përritje të pagave dhe 5 euro që rritet në vitet që vijnë, janë këto që e kanë përcaktuar këtë buxhet për paga. Komuna nuk mund të shtoj numër të punëtorëve.

**z. Zafer Gashi:** Shumë e vërtetë ajo që thatë ju z. Berisha. Por vjelja e taksave, qirave mendoj që nuk është duke u bërë si duhet prandaj e keni vendosë atë shifër. Sa i përket punësimeve – kontratave në vepër ju si qeveri jeni kampion.

z. Fadil Gashi, kryesues tha se është mirë që të referohemi bazuar në KAB e të mos merremi me çështje që i takojnë raportit financiar i cili çdo tre muaj e shqyrtojmë. Në korniza të trasha KAB është prezantuar por natyrisht që ka me pas lëvizje posa të futemi në hartimin e buxhetit. Sa i përket expertit që përmendi Zaferi, Gjeografin

jashtë këtij kuvendi ndoshta ju ka ngatrru me ndonjë raport tjetër sepse nuk akt ë tillë në hartimin KAB.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Përvendetje të gjithëve. Me të vërtetë është e drejt kërkesa e disa asamblistëve që të rritet buxheti në bujqësi. Mendoj që këto investime janë të parapara në këtë dokument. Ne kemi tërhequr edhe projekte të tjera dhe çdo vit ka rritje. Vetëm këtë vit investime në kanalin për ujitje të tokave janë gjysme milion euro. Shpenzimet e ndërlidhura me zyrën e kuvendit, subvencionet e bujqësisë e shumë e shumë të tjera janë koncentruar në zyrën e kryetarit e nuk janë mjete që i shpenzon zyra e kryetarit ekskluzivisht. Korniza është e bazuar në kufijtë buxhetor që vijnë nga ministria e financave. Gjeografi që u përmend është tek një projekt i fituar tenderi nga UBT që ka të bëjë me planin zhvillimor komunal. Ne po bëjmë të pamundur përmes grandëve që të i ndihmojmë bizneset e vogla. Kushtrimi e përmendi projektin e rrëthimit të varrezave të Komunës, është fjala për komplet varrezat në territorin e Komunës. Rruga në Shtupel është paraparë që të i shtohet një shtresë sipër që të stabilizohet. Po ashtu rruga "Afrim Haliti" në Jashanicë etj. Parimisht po flas, gjithmonë kam kërkuar bashkëpunim nga ju. Shqetësimet që i paraqitet në Kuvend për ftesë për debate e dëgjime. Ju vet i keni aprovuar datat e mbajtjes së debateve publike, s`ka arsyet thoni që nuk na kanë ftuar. Lagja mbi stacion tanë më është në [përfundim instalimi i ndriçimit publik. Me gjithë këtë unë ju pres për bashkëpunim dhe bashkërisht do të vendosim për të gjitha.

**z. Ndrec Zefaj:** Duke e parë që shkaku i ndryshimeve klimatike bujqit nuk po e akne të sigurt prodhimin, a do të kishim mundësi që nga 2024 të caktohet një linjë buxhetore vetëm për dëmet bujqësore. Edhe solide nëse është të caktohet duke shpresuar se me rritje të buxhetit të rritet edhe kjo linjë buxhetore.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** kemi mundësi por mundësitë janë të vogla. Kjo kërkesë do të duhet të gjejë zgjidhje në qeverinë e Kosovës. Fonde të tillë do të duhej të ndahen edhe në shëndetësi. Janë gjera që do të duhej të jenë në përgjegjësinë e nivelit qendror por edhe ne kemi mundësi sadopak.

**Me 22 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 6 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanak.**

**z. Enver Berisha, drejtor i FEZh:** Është shuma që ne e kemi bartur nga viti i kaluar por me vendim të qeverisë na janë marrë këto mjete. Pas një debati qeveria vendosi që këto mjetet të kthehen prap në komuna. Këtu keni listën se nga kanë me shkuar këto mjete, Versioni i parë është votuar në kuvend e e njëjtë me pak ndryshime të vogla është sot prezantuar para juve.

**Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vënies në diskutim publik të planit komunal për integritet.**

**Me 22 vota për, asnë kundër dheasnë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 8 e Rendit të ditës: Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të dëgjimeve publike për draft strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 2023-2026 dhe draft planit të veprimit për informim dhe komunikim 2023-2026.**

**Znj. Vlora Tafilaj, zyrtare për informim:** Përshtënjetje për të gjithë. Sa i përket procesit të konsultimeve publike raportin si për KAB për buxhetin e vitit të kaluar e kemi sjellë në kuend dhe vazhdimisht kemi raporte nga procesi i konsultimit publik, rregullorja për menaxhimin e mbeturinave etj. Tash jemi për përgatitjen e strategjisë së komunikimit publik, zyrës për informim, do ta kemi dhe buxhetin e këtij viti dhe vitit të ardhshëm dhe unë ju ftoj që të jeni pjesë e këtyre dëgjimeve. Arsyë që ne i sjellim me vonesë këto raporte është sepse duhet të i respektojmë afatet kohore që ajnë goxha të gjata. Stafi i kufizuar në departamentet e komunës dhe angazhimet e madha tonat si staf i zyrës janë edhe një nga arsyet e vonesave të tilla

**Pika 9 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft strategjisë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun 2023-2026**

**Me 20 vota përasnë kundër dheasnë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 10 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të veprimit për informim dhe komunikim 2023-2026**

**z. Arben Limanaj:** A parashihet hapja e llogarive të drejtoreve në Facebook. Në vitin 2019 kryetari pati marr një vendim për tu mbyllur këto llogari ku disa i akne mbyllur e disa nuk i akne mbyllur asnjëherë.

**Znj. Vlora Tafilaj, zyrtare për informim:** z. Limanaj zyra për informim e ka përgatitur planin e veprimit. Sa i përket hapjes së faqeve të tilla, ne përmes ueb faqes zyrtare të komunës do të i përcjellim dhe publikojmë të gjitha aktivitetet.

**z. Besiana Gashi:** Dua të theksoi se në faqen zyrtare të komunës në Facebook asnjëherë nuk është postuar asnë informacion për komitetin për komunitete.

**Me 19 vota përasnë kundër dheasnë abstenim U MIRATUA**

**Pika 11 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit të punës së KKSB-së për 6-shtë mujorin e parë të vitit 2023.**

**Znj. Marqe Selmanaj, nënkyetare e Komunës:** Në Raportin e Këshillit për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023. mund të konstatojmë se gjithçka ka filluar me kohë, përmes takimeve dhe aktiviteteve është bërë riorganizimi i Planit për takimet e KKSB-së. Plotësimi i Planit të punës së KKSB-së me tematika të reja për vitin 2023, numri i takimeve, natyra e takimeve të cilat janë kryesisht tema që prekin sigurinë në komunën tonë. Sipas kërkesave të anëtarëve për Siguri në Bashkësi, kemi bërë zëvendësimin e anëtarëve të larguar me anëtarë të rinj, të

propozuar nga institucionet përkatëse, prej ku edhe përfaqësojnë këtë Këshill, duke ndjekur të gjitha procedurat e caktuara me Rregulloren përkatëse për KKSB. Temat e rendit të ditës janë të nxjerra nga Plani vjetor i punës së KKSB-së, ku përcaktohen objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtronë nga anëtarët e KKSB-së në përbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Takimi i parë u realizua me 27.02.2023, duke kaluar nepër të gjitha procedurat e nevojshme.

KKSB-ja ka për synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e Komunës së Klinës. Takimet e KKSB-së, dy takimet e parapara për këtë gjashtëmujor i ka kryesuar nënkyetarja Komunës së Klinës, Marqe Selmanaj, e cila ka propozuar rendin e ditës, si dhe në takimin e parë beri prezantimin e Planit te KKSB-së. Pasi prezantoj të gjitha pikat e rendit të ditës u ndal të siguria në komunë si dhe u dha prioritet dhe ftoi në bashkëpunim të vazhdueshëm të gjithë akteret, siç janë: përfaqësuesit e KKSB-së dhe qytetarët e Komunës së Klinës, që të identifikojnë problemet. Komandanti i policisë ka raportuar në të dy takimet për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Klinës. Bashkëpunimi i policisë me komunën, anëtarët e KKSB-së si dhe bashkëpunimi me qytetarë ka qenë në nivel shumë të lartë. Përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, bashkësive fetare, pos kërkesave dhe sugjerimeve, kanë qenë falënderues sa i përket sigurisë nga ana e policisë së Kosovës si dhe nga ana e komunës së Klinës, për bashkëpunim dhe zgjidhjen e kërkesave të parashtruara. Ka pasur diskutime të ndryshme nga të gjithë anëtarët e KKSB-së, përfaqësues nga Këshilli i Prindërve dhe OJQ-ve për probleme të ndryshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshmen me të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Klinës. Në takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga OSB-ja, KFOR-i, FSK-ja, etj.

Gjate kësaj periudhe kohore janë mbajtur dy takime të rregullta të KKSB-së nga gjashtë të parapara, të gjitha materialet për mbajtjen e takimeve u janë dorëzuar me kohë anëtarëve dhe pjesëmarrësve të cilët kanë qenë të ftuar në takim.

**Pika 12 e Rendit të Ditës: Rishqyrtimi i vendimit i miratuar me 28. 04. 2023 sipas shkresës së MMPhi.**

Fjala është për emërimin e rrugës me emrin e ish senatorit dhe humanistit Villi Kupers. Kryesuesi i kuvendit theksoi se janë marrë të gjitha masat dhe janë bërë të gjitha harmonizimet e kërkuar nga ministria.

**Me 20 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenum u plotësua vendimi me kërkesën nga ministria.**

**Pika 13 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i grupit të LVV për zëvendësim të anëtarëve.**

Kryesuesi theksoi se LVV në Klinë nuk mund të ju drejtohet kryesuesit të kuvendit për Rend dite. LVV në Klinë mund të i drejtohet me kërkesa të tilla përmes grupit të LVV në Kuvend. Është një kërkesë miqësore dhe zyrtare theksoi kryesuesi Gashi.

**z. Valmir Bacaj:** Prap për këto kërkesa ne duhet të ju referohemi udhëzimit administrativ, Ky udhëzim e rregullon këtë çështje, konkretisht neni 18. Unë kerkoi sqarim se a është përbushur ndonjëra nga pikat e këtij udhëzimi për zëvendësim të këtyre anëtarëve të komiteteve.

Kryesuesi theksoi se për vendimin final duhet të merret votë formale por sipas praktikës ne gjithmonë i kemi respektuar kërkesat e subjekteve për zëvendësim. Ajo që nuk do të pajtohesha me zëvendësim është tek komisioni për emërtimin e rrugëve i cili komision e ka kryer 80% të punës. Një anëtar i ri në këtë komision nuk e ka idenë se çfarë është punuar deri tanë, tha z. Fadil Gashi. Ky kuvend e ka sankzionuar me vendim mandatin e komisionit për emërimë me mandatin e anëtarit të kuvendit. Që të bëjmë zëvendësimë në këtë komision ne duhet që ta anulojmë vendimin e parë të themelimit.

**z. Arben Limanaj:** Nga praktika ne i kemi respektuar centrimet e subjekteve politike për ndryshime të anëtarëve të komisioneve dhe komiteteve. Në këtë rast të komisionit për emërimë të rrugëve nëse është i definuar mandati nuk mund ta ndryshojmë të tjera mendoj që duhet të i respektojmë kërkesat e subjekteve.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Komisioni për emërimë nuk është si komisionet dhe komitete e tjera. Në këtë komision ka edhe anëtarë që nuk janë anëtarë te kuvendit.

z. Valmir Bacaj tha se tek komiteti i arsimit behet fjalë që të zëvendësohet një anëtarë e kuvendit me një anëtar jashtë kuvendit kjo bije ndesh me ligjin që e determinon shuam çartë përbërjen e Komitetit që thotë se shumica e anëtarëve të komitetit duhet të janë anëtarë të kuvendit.

**z. Tunë Dedaj:** Ne jemi pajtuar si Aleancë kur është bërë fjalë për KPF por tanë nuk është mirë që të i merret e drejta që i takon një asamblisti.

**z. Zafer Gashi:** Ashtu siç shihet vendimi që është marrë në këtë kuvend e përcakton mandatin e anëtarëve të komisionit për emërimë ndërsa sa i përket komiteteve mos ta bëjmë precedent mos na detyroni që ta dërgojmë prap në ministri sikurse herën e kaluar.

Grupi i LVV pranoj që të tërhiqet nga zëvendësimi i anëtarit të komisionit për emërimë të rrugëve por kërkon që të respektohet kërkesa për zëvendësim të anëtarit nga Komiteti për arsim, kulturë , rini dhe sport.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Këtu është një problem sepse neni 14 shpjegon përbërjen e komitetit ku thotë se në çdo komitet shumica duhet të janë anëtarë të kuvendit dhe në këtë rast vetëm nëse ju liron vendin ndonjëra nga subjektet e tjera sepse nëse hiqet anëtarë i kuvendit shkëlet udhëzimi pasi që shumica nuk do të janë anëtarë të

kuvendit. Pra shumica duhet të jenë anëtarë të kuvendit nga 5 anëtarë sa ka komiteti në fjalë. Propozoj që të tërhiqet kërkesa për zëvendësim dhe në seancën e radhës të koordinoheni pa e shkelur vullnetin politik dhe udhëzimin administrativ.

**z. Zafer Gashi:** propozimin tuaj që të shtyhet po e pranojmë edhe pse e dimë përfundimin. Po e përmendi moralin , ai që është larguar nga subjekti politik është e moralshme që të tërhiqet nga pozitat që i ka pasur sa ka qenë pjesë e subjektit.

Kryesuesi tha në lidhje me këtë se është dakord që të zëvendësoni anëtarin nga subjekti i juaj por nëse hiqet anëtar i kuvendit të vendoset një anëtar tjetër i kuvendit.

**Znj. Lirije Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Unë nuk dua të heq dorë nga komiteti në fjalë, jam aktive. Me vota jam zgjedhur me vota mund të më heqin. Unë punoj për arsim, kulturë, rini dhe sport për qytetarët pa mëditje edhe ashtu nuk kemi marrë mëditje asnjëherë.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Prandaj po them që të zhvendoset pasi që me 3 vota të LVV as nuk je zgjedhur atëherë as nuk mund të shkarkohesh tani. Të shikohet mundësia për seancën e radhës pa e shkelur udhëzimin administrativ.

#### Pika 14 e Rendit të ditës: Pyetje dhe përgjigje.

**Znj. Fatjona Gashi, drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport:** Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket pyetjes së Kushtrim Halilit, ftesa është dërguar me datë 2 qershor në orën 11 e 4 minuta. Ftesa i është dërguar kryesuesit Fadil Gashi, bashkangjitur z. Ahmet Berisha.

Drejtoresha bëri përshkrimin e ftesës së festivalit duke theksuar se nuk e ka ditur se Ahmet Berisha është në pushim sepse nuk menaxhon sektorin e burimeve njerëzore. Po ashtu edhe ftesa për ditën e çlirimt është dërguar me datë 15 qershor në adresë të kryesuesit z. Fadil Gashi, Ahmet Berisha dhe Donika Kamberi. Ahmeti gjithmonë i është përbajtur detyrave të tija por unë nuk kam qenë në dijeni që është në pushim vjetor si dhe asistentja e kryesuesit. Ky lëshim është bërë sepse ne nuk e kemi ditur që këta punëtorë janë në pushim vjetor. Si Fatjonë ndjehem keq që nuk e kanë marrë ftesën por si drejtoreshë unë e kam kryer me përgjegjësi detyrën time. Ajo e cila qëndron është se nuk e kam ftuar në këshillin organizativ të festivali OVL. Për këtë unë kërkoj falje publike por edhe kjo ka një arsy. Nuk i kam ftuar që të jenë pjesë e K.O. sepse nga ky kuvend po ndahet buxheti, nga zyra e prokurimit bëhen të gjitha procedurat, gjë që festivali sot nuk shkon me donatorë dhe unë e kam paraparë që të punohet në grupe më të vogla. Tek OVL kemi qenë bashkë me kryetarin e komunës, drejtorin e administratës dhe drejtorin e shërbimeve publike para festivali dhe kemi kërkuar nga OVL që të na japid një listë të personave që duhet të presim dhe të ju krijojmë vende për sistemim për shkak të nderit që kemi ndaj tyre.

“ “faji” po i mbetet por duhet të dihet se nuk jemi në shërbim të askujt. Ju jeni shumë korrekte dhe kam shumë respekt për punën tuaj drejtoreshë”, theksoi Kryesuesi.

Kryesuesi vazhdoi duke thënë se ftesat për ditë të çirimit ju kanë shkuar me kohë anëtarëve të kuvendit. Për pjesëmarrje ose jo anëtarët e kuvendit duhet të konfirmojnë paraprakisht në mënyrë që të ju sigurohet ulëse.

**z. Tunë Dedaj:** Unë ju përgëzoj që festivali ka shkuar në rregull por anëtarëve të kuvendit nuk ju ka rezervuar ulëset. Ndoshta kjo ka qenë edhe arsyjeja pse nuk kanë marrë pjesë. Në të ardhmen është mirë që të ju sigurohet ulëse anëtarëve të kuvendit.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Pjetja në lidhur me përfituesit nga vërshimet e muajit nëntor 2022. Lista është aprovuar në kuvend dhe e cila listë ka kaluar përmes procedurave të kuvendit dhe sipas udhëzimeve administrative është dërguar në agjensionin për emergjencë ndërsa agjensioni e dërgon tutje në ministri. Kemi bërë pyetje në agjension dhe gojarisht më është thënë se pritet marrja e vendimit të qeverisë. Sa i përket pyetjes lidhur me raportin e kërkesave për ndihmë mjekësore, procedurat janë sipas kompetencave që ka kryetari por gjithmonë duke kaluar përmes një komisioni që bënë vlerësimin dhe më rekomandon mua. Unë e kam këtu kopje fizike listën nëse doni mund të jua jap.

**z. Zafer Gashi:** Ne nuk do të bëjmë pyetje fare për dy pikat që kemi kërkuar interpelancë. Për kryetarin pasi që nuk është këtu drejtori i urbanizmit: Tentimet që po bëhen atje tek hapësira e fabrikës së cimentos, tentimet për të gërmuar etj., a ka leje ai operator për punën që po tenton të bëjë. Pyetja tjetër për drejtorin e shëndetësisë: keni premtuar që do ta sjellin draft statusin e QKMF-së, tek zgjedhja e drejtorit, kriteret a do ta leni kriter që të jetë Specialist i Mjekësisë familjare apo edhe i sferave të tjera. Duhet at dini edhe një gjë, në QKMF nuk mund të ketë zv drejtor, mos të ketë pozita përgjegjëse që nuk i parashev statusi.

Kryesuesi theksoi se drafti i statusit të QKMF është dërguar tek ne dhe ne do ta shqyrtojmë atë draft.

**z. Agron Bacaj, drejtor i shëndetësisë:** Të falënderoj që po na parandalon që të shkelim ligjin por kur ne të vendosim me e shkel ti nuk mund të na ndalosh. Zv drejtor QKMF nuk ka pasur asnjëherë. Statusi final aprovohet në Kuvend më pastaj procedohet tutje.

Në këtë pikë u zhvillua një debat interaktiv që ishte e pamundur të përcjellët në procesverbal.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Asnjë aktivitet në lidhje me fabrikën e cimentos nuk është duke u bërë në hapësirat ku e përmendi Zaferi ndërsa për aktivitete të tjera janë kompetencë është KPMM dhe ministrisë së mjedisit dhe jo e Komunës.

**z. Tunë Dedaj:** Mua më ka rënë disa herë që të marr shërbimet në QKMF dhe dua ta falënderoj drejtorin për punën e shkëlqyer që po bëhet aty.

**Znj. Valmira Krasniqi:** Nga një interesim i qytetarëve dua të dijë nëse ka prona komuna e Klinës në hapësirën pas stacionit të policisë.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Në seancën e radhës do të sjellim informacione të sakta.

Kryesuesi në vazhdim vuri në mikrofon një zhurmë që tingëllonte sikurse këngë. Ai tha se kjo është incizuar në orën 11 e 45 të natës nga dhoma e shtëpisë së tij. Është një zhurmë e padurueshme që ndodhe çdo natë dhe na është bërë e padurueshme. Qytetarët janë në zor nga këto zhurma nëpër lokale. E kam diskutuar edhe me inspektorët, mendoj që është koha që të disiplinohen dhe të ju përbahen ligjeve dhe akteve nënligjore. Është një shqetësim shumë i madh sepse është bërë e padurueshme.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Është shqetësim me vend. Tani ekzekutivi është pajisur edhe me një aparat për matjen e zhurmës dhe natyrisht që do të marrim të gjitha masat që qytetarët të kenë qetësinë e tyre në kohën kur duhet ta kenë qetësinë.

Pas fjalës së kryetarit, kryesuesi duke falënderuar të gjithë për angazhim dhe kontribut shpalli të myllura punimet e kësaj seance.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesues:

Fadil Gashi

